



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:207786  
Datë: 06.11.2024  
Numri i dokumentit: 06412945

P.nr.443/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me procesmbajtësen Fatmire Sermaxhaj në lëndën penale kundër të pandehurit F. I., me vendbanim në rrugën "Xhevat Ajvazi" 3/5, në Gjilan, për shkak të veprës penale Ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.974/2024, të datës 23.07.2024, dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr.974/2024, të datës 23.07.2024 më datë 06.11.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit: **F. I.**, nga babai H. dhe nëna M., e lindur M., i lindur më datë 29.06.1990, me vendbanim në ,rr. "Xhevat Ajvazi" 3/5, në Gjilan ,ka të kryer shkollën e larte, punëtor në Call Center Swiss Group, i pa martuar, me gjendje të mesme ekonomike, me nr.personal: .....,shqiptar,shtetas i Republikës së Kosovës.

**Është fajtor**

Sepse prej datës 28.Qershor 2024 e deri më datë 01.Korrik 2024, në rrugën " Sadulla Brestovci" në Gjilan ,me qëllim të sjelljeve të vëmendjes së vazhdueshme dhe të pa dëshirueshme të ngacmimit, i pandehuri F. I. në vazhdimësi me dashje, me qëllim të përcjelljes dhe vëzhgimit ka shqetësuar , ish të fejuarën e tij ,tani të dëmtuarën E. J., ashtu që të njejtën e shqetëson duke e thirrur me numra të panjohur në telefon , duke shkuar kah shtëpia e saj si dhe ia ka vendosur nje GPS në veturën e saj të markës Opell me tabela të regjistrimit 06-..... , me qëllim të përcjelles së saj ,ashtu që i pandehuri me veprimet e tij tek e dëmtuara shkakton ndjenjën e pasigurisë ,frikë dhe shqetësim të madh emocional

- me çka ka kryer veprën penale, **Ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 i KPRK.**

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38,40, 43,45,69 të KPRK-ës, si dhe nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurës i shqipton,

**DËNIM ME GJOBË**

**I.** Të pandehurit F. I., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim i pandehuri është e obliguar që ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

**II.** Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurin mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€ (njëzet euro) ndërsa, nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë

dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

**III.E** dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**IV.** Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe 20 (njëzetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit F. I., me vendbanim në rrugën “Xhevat Ajvazi” 3/5, në Gjilan, për shkak të veprës penale Ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t’i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit Fitim Islami, me vendbanim në rrugën “Xhevat Ajvazi” 3/5, në Gjilan, për shkak të veprës penale Ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor.

Gjendja faktike vërtetohet: Rasti iniciuar me numër 2024-CA-0968, të datës 07. Shkurt 2024, deklarata e të dëmtuarës E. J., deklarata e të pandehurit F. I., raporti I zyrtarit policor, një GPS si dhe shkresa të tjera që ndodhen në dosjen e lëndës, vërtetojnë se i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale Ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurës, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK-s.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP-s, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.443/2024, Më 06.11.2024**

**Procesmbajtësja**  
**Fatmire Sermaxhaj**

**Gjyqtari,**  
**Behar Ymeri d.v**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.